



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 574/10 Prot.

Tiranë, më 23 . 10 . 2015

V E N D I M
Nr. 117 , datë 23 . 10 . 2015

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me Urdhrin e verifikimit Nr.571/1 prot, datë 07.08.2015**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Institucionin e Ministrisë së Mbrojtjes për rastin e nëpunës ***** ,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr.571/1 prot, datë 07.08.2015, " Të verifikimit të informacionit të ardhur nga ***** , në adresë të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ", është nisur verifikimi në lidhje me, Vendimin e Komisionit Disiplinor Nr. 6158/5, datë 22.07.2015 "Largim nga shërbimi civil" të nëpunës civile ***** , "specialist" në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Mbrojtjes.

Nga shqyrtimi i akteve të sjella me kërkesën nr. 571 prot, datë 30.07.2015 të nëpunës ***** , praktikës shkesore marrë gjatë inspektimit në Ministrinë e Mbrojtjes, si edhe nga korrespondenca me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë rezulton se, punonjësja ***** ka filluar punë me Urdhrin Nr. 2013, datë 20.11.2012, në pozicionin "specialist" në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes. Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e ka gjetur në punë në këtë pozicion dhe meqë kishte mbushur një vit nga koha e fillimit të punës, në bazë të pikës 3 të nenit 67 të ligjit në fjalë, ajo është deklaruar nëpunëse civile.

Në datë 03.06.2015 Drejtori i Menaxhimit të Aseteve, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me cilësinë e eprorit direkt, bazuar në ligjin nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, gjurmën a) të pikës 1, gjurmën a), b) dhe c) të pikës 2 të nenit 57, gjurmën a) të pikës 4, të nenit 59, pikën 1 dhe 2 të nenit 43; ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 *“Për rregullat e etikës në administratën publike”*, neni 3; VKM nr.115, datë 05.03.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*; pasi ka analizuar ecurinë e punës së nëpunëses ***** , dhe ka konstatuar se në veprimet dhe mosveprimet e saj ka shkelje të rënda dhe shumë të rënda të disiplinës së punës, ka kërkuar nga Komisioni Disiplinor fillimin e procedimit disiplinor ndaj ***** , specialiste në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes.

Në datën 04.06.2015, në bazë të Urdhrit Nr.917, të Sekretarit të Përgjithshëm ***** , është ngritur Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Mbrojtjes, për shqyrtimin e kërkesës Nr.2035, datë 03.06.2015; *“Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor, për nëpunësin civil *****”*, të Drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Aseteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, i cili ka filluar trajtimin e çështjes në bazë të nenit 59, pika 2 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar me ligjin nr.178/2014, të kreut të I-rë pikat 1,2 dhe 5 të Vendimit nr.155, datë 05.03.2014, të Kreut të II-të, të Udhëzimit nr.1, datë 02.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike.

Në përfundim të procesit të shqyrtimit të masës disiplinore, hetimit dhe vlerësimit të rrethanave të çështjes, rezulton se Komisioni Disiplinor ka arritur në përfundimin se, punonjësj ***** , në mënyrë të përsëritur ka kryer shkelje shumë të rënda si p.sh; nuk ka zbatuar detyrën për të marrë pjesë në mbledhjen e Shtabit të Përgjithshëm; ka refuzuar të pasqyrojë vërejtjet dhe komentet e bëra nga eprori i drejtpërdrejtë mbi shkresat që konceptohen nga ajo dhe firmosen nga drejtori; ka refuzuar të përgatisë shkresat sipas kërkesave të qytetares dhe detyrës së ngarkuar nga eprori direkt; nuk ka respektuar afatet e vendosura në përfundim të detyrave; ka refuzuar të zbatojë detyrat; nuk ka përgatitur shkresat me prioritet *“Urgjent”* dhe dërgim shkresë në sekretarinë e Ministrisë së Mbrojtjes, pa firmën e eprorit të drejtpërdrejtë, etj. Përsa më sipër, bazuar në ligjin nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, me ligjin nr.178/2014 neni 57, pika 2, gjurmën a) dhe b), neni 58 gjurma ç), dhe neni 60, pika 3, Komisioni Disiplinor me Vendimin nr.6158/5, datë 22.07.2015, ka vendosur :

Marrjen e masës disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”* për nëpunësen ***** me detyrë *“specialiste”*, në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve Fikse dhe Veprimtarive, në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes.

Në datë 23.07.2015, me Vendimin Nr.6197 prot., drejtuesja e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, në zbatim të gjurmës b) të nenit 63 të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Kreut VII, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, ka vendosur *“Lirimin nga shërbimi civil”* të ***** me detyrë *“specialiste”*, në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve Fikse dhe Veprimtarive, në Drejtorinë e

Menaxhimit të Aseteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes.

Gjithashtu, rezulton se përveç sa më sipër, ndaj veprimeve administrative të Ministrisë së Mbrojtjes, ***** i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me një kërkesë sigurim padie, me anë të së cilës ka kërkuar:

*Sigurimin e padisë kundër Vendimit nr.6158/5 datë 22.7.2015 të Komisionit Disiplinor të ngritur nga Ministria e Mbrojtjes “Për largimin e nëpunësit civil ***** nga shërbimi civil”.*

Rezulton se, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin Nr. regj.them 100(31021-04874-80-2015) datë 31.07.2015 ka vendosur :

*Rrëzimin e kërkesës për sigurim të padisë të kërkuar *****.*

Në vijim, me shkresën nr.9813/1 prot, datë 05.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se është regjistruar pranë saj çështja gjyqësore me nr.31104-05342-80-2015, datë regjistrimi 04.09.2015, me palë paditëse ***** dhe palë të paditur Ministria e Mbrojtjes dhe Departamenti i Administratës Publike. Objekti i padisë është : “Konstatimi i pavlefshmërisë absolute i aktit administrativ Vendimit të Komisionit Disiplinor nr.6158/5, datë 22.07.2015, për largimin nga shërbimi civil të nëpunëses ***** , specialiste në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes, të ngritur me Urdhrin nr.917, datë 04.06.2015. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit të ndërmjetëm të Komisionit Disiplinor nr.3/7, datë 03.07.2015 ”. Detyrimi i Ministrisë së Mbrojtjes, Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes ***** për të filluar procedurën disiplinore ndaj ***** , me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Aseteve në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e eprorit direkt dhe Kryetarit të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Mbrojtjes. Shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, sipas ligjit të posaçëm.

Nga sa më sipër rezulton se, kjo çështje është duke u shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Në kushtet kur neni 36 i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se “ Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”, vlerësoj se në këtë rast, nuk është e nevojshme për t’u investuar apo për të ndërhyrë nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenin 16 dhe 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me Urdhrin e verifikimit Nr.571/1 prot, datë 07.08.2015, “Për verifikimin e informacionit në lidhje me, Vendimin e Komisionit Disiplinor Nr. 6158/5, datë 22.07.2015 “Largim nga shërbimi civil” të nëpunësit civil ***** , specialiste në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Mbrojtjes.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Ministria e Mbrojtjes si dhe kërkuesja, ***** .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA